



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



Në baze të nenit 4 të Rregullores Nr.08/2017 për Praktikant në Gjykata dhe Sekretariatit e KGJK-së, Gjykata Themelore në Prishtinë më date 19.01.2021 shpall:

**K O N K U R S**

Nr. 01/2021

Titulli i vendit të punës: Praktikant vullnetarë

1. Gjykata Themelore në Prishtinë-----50 pozita,
  - Dega në Podujevë ----- 10 pozita,
  - Dega Lipjan ----- 10 pozita,
  - Dega Drenas ----- 7pozita,
  - Dega Graçanicë ----- 2pozita.

Nëpunësi mbikëqyrës: Administratori i Gjykatës

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti (pa pagesë)

Vendi: Gjykata Themelore në Prishtinë.

Përshkrimi i detyrave të punës: Detyra e praktikantit: Ndhmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore: Vepron në mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të kryetarit të Gjykatës dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të administratorit të Gjykatës;

Ndhmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi;

Ndhmon gjyqtarët në punët që kanë të bëjnë me futjen e lëndëve në dosje; Ndhmon në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, hetimet, gjykimet etj.

Kryen edhe punë tjera sipas nevojës:

Kualifikimet:

- Diploma e Fakultetit Juridik, programi i studimeve (4) vjeçar apo 240 kredi ECTS ose Master,

Aftësitë e kërkuara: • Njohuri të procedurave gjyqësore;

- Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- Njohuri të mjaftueshme ligjore;

Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

VEREJTJE: • Procedura e konkursit është e hapur për kandidatë të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues. • Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi shërbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregulloren, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil dhe Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikantëve

- Konkursi është publikuar më dt. 19.01.2021 dhe mbyllet me dt.02.02.2021.

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Prishtinë Pallati i Drejtësisë, objekti A- Lagjja "Prishtina e Re", Rr.: "Nekibe Kelmendi" pn. Tel.038- 200-17-526, gjyqësori-rks.org.

### [Shkarko Aplikacionin](#)

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

- Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11,pragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkuron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata të tjera, dy rekomandime etj. Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë t'i tërheqin prapa.

- Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni zyrtaren/in e personelit në numrat e lartëcekur.